



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-19-6077-5-3-6/C205  
14 Nr. 975/19  
Dt. 27.09.2019

## KONTRATË PUNE/SHËRBIMI

### Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **NNP “ Wenda “** me seli në Vushtrri, me **NRB: 80281714** e **Nr. Fiskal: 600203939**, të cilën e përfaqëson **z. Kadri Selmani**, në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I PUNËVE/ SHËRBIMEVE**, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: : **Rehabilitimi i fushës sportive në fsh. Gllavotin**, me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	60	7	7	5	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	9	6	5	3	6

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve rehabilituese dhe punëve tjera në fushën sportive në fsh. Gllavotin, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. Afati i fillimit të punëve është jo më gjatë se dy ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se 15 ditë pune pas datës së fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve dhe / ose Punëve.

1.3 Vendi i rregullimit të objektit – fushës sportive është fsh. Gllavotin.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3.439,99€ ( tremijkatërqindshtridhjetenëntë/99 Euro)**.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Organi Mbikëqyrës. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Organi Mbikëqyrës do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për punimet dhe / ose shërbimet e përfunduara dhe / ose pranuar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punëve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni, përmes Deklaratës me shkrim, do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve dhe / ose shërbimeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f).

Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:





- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:  
NNP "Wenda" – Vushtrri

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e  
Vushtrrisë

<b>Emri:</b>	<b>Kadri Selmani</b>	<b>Emri:</b>	<b>Saranda Cakaj</b>
<b>Pozita:</b>	Pronar	<b>Pozita:</b>	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	27.09.2019	<b>Data:</b>	27.09.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G  
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 18, 8 apo 0, e jo në formatin 18%-apo-8%-apo-0%,  
 Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmimi duhet shkruar me dy decimale pasë presjes dhe tore


Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
<b>1</b>	<b>Punët Paraprake</b>								
1.1	Shënim i trasësë para fillimit të punimeve dhe identifikimi të gjitha dëmëve në teren dhe rrethojë	m'	340.0	0.34	18.00	0.40	115.25	20.75	136.00
<b>2</b>	<b>Punët e Demolimit dhe montimit</b>								
2.1	Demolimi me kujdes i rrethojës rrjetë e plastifikuare me dimensione h=2,5m'L=355m', materiali i demoluare duhet të trajtohet me mundësi të shferezimit të mëtejshëm për qëllime të tjerit sportiv	m'	250.0	0.59	18.00	0.70	148.31	26.69	175.00

2.2	Kosja e shkrove dhe barishtave në terren sportiv dhe hapsirave ne distanc b=10m' në tërë përimetrin e rrethojës , kosja të bëhet me mjete të cilat do ta kosin në lartësi minimum h=1cm nga sipërfaqja e tokës , në këtë pozicionë të përfshihet edhe transporti i barshatave dhe shkurave ne vendin e caktuarë nga org. mbikqyrës	m <sup>2</sup>	12.500.0	0.05	18.00	0.06	635.59	114.41	750.00
2.3	Furnizimi ,me material ,dhe lyerja me ngjyrë e të gjitha shtyllavemetalike me dimensione 4x4x250cm te vendosura në qëdo 2.20m'egzistuese të rrethoje me llakë në dy shtresa	m'	300.0	0.81	18.00	0.95	241.53	43.47	285.00
2.4	Furnizimi ,me material ,dhe lyerja me ngjyrë(llak) e portave metalike , në këtë pozicionë të përfshihet edhe punët e pastritit dhe përgaditjes për ngjyrosje të konstruksionit metalik	copë	2.0	76.27	18.00	90.00	152.54	27.46	180.00
2.5	furnizimi me material , punimi dhe montimi I shtyllave metalike 40x40x4mm dhe lartësi h=3m , në këtë pozicionë është përfshirë edhe punët e gërmit dhe betonimi I themeleve të vequara me dimensione 40x40x60cm	opë	26.0	21.19	18.00	25.00	550.85	99.15	650.00
2.6	Furnizimi me material dhe saldimi I portave metalike sipas gjenjes faktike në vend , në këtë pozicionë të përfshihet edhe punët e montimit dhe vendosja e rjetava n ëporta	copë	2.0	182.20	18.00	215.00	364.41	65.59	430.00

Numri i prokurimit: VU644-19-6077-5-3-6nr. i brendshem: VU644-19-096-536Titulli: Rehabilitimi i fushës sportive në fsh. Gllavatin

2.7	Furnizimi me material dhe montimi i rrejes së plastifikuar me lartësi H=2,20m' dhe dimensione të fushave 5cmx5c dhe trashësi të teilit 2,4mm, në këtë pozicionë është përfshirë edhe tri fije teilit njata në tërë perimetrin e rrehojes duke e vendosur sipas urdhrave të org. mbikqyrës	m <sup>2</sup>	646.5	1.09	18.00	1.29	706.77	127.22	833.99
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH :</b>							2,915.24	524.74	3,439.99

W

<b>IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)</b>	
<b>EMRI I OE:</b>	NNP "WENDA"
<b>EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:</b>	Kadri Selmani
<b>NËNSHKRIMI:</b>	
<b>DATA:</b>	28.08.2019 08.08.2019
<b>VULA:</b>	